	PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS		F-009-4
	Prishtinë	v. 1.1	Faqe 1 nga 2

Përshkrimi i vendit të punës

Data e hyrjes në fuqi: 07.07.2021

Pozita:

Menaxher i Projekteve



Përmbledhje

Menaxheri i projekteve është përgjegjës për inicimin, koordinimin dhe menaxhimin e projekteve të llojeve të ndryshme brenda KEC.

Kualifikimet


- Përgatitje superiore shkollore;
- Aftësi menaxheriale – preferohet përvojë 3-vjeçare e punës në pozita menaxheriale;
- Njohje e mirë fushës ku menaxhon projekte;
- Njohuri të avancuara të kuptuarit dhe shkruarit të gjuhës shqipe dhe angleze;
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike, me qëllim të organizimit të punës.

Aftësitë tjera

- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe të punës me të dhëna sasiore dhe cilësore;
- Aftësi të shkëlqyera të punës me njerëz;
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit;
- Aftësi për të punuar nën stres.

Detyrat

- Kujdeset për menaxhimin e projekteve sipas udhëzimeve të drejtorit ekzekutiv;
- Monitoron dhe vlerëson zbatimin e projekteve;
- Përgatit raportet narrative dhe ofron përkrahje për përgatitjen e raporteve financiare të projektit që e menaxhon
- Siguron komunikim adekuat me donatorët dhe partnerët e projektit
- Përgatit për publikim materialet e trajnimit;
- Krijon rrjetin e bashkëpunëtoreve;
- Kujdeset për zhvillimin profesional të bashkëpunëtoreve;
- Siguron burimet e nevojshme për përgatitjen dhe realizimin e projekteve;

	PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS		F-009-4
	Prishtinë	v. 1.1	Faqe 2 nga 2

- Bën prezantimin e projekteve;
- Përgatit informacione për realizimin e projekteve;
- Kryen punët administrative nga fushëveprimi i vet;
- Me urdhër të drejtorit ekzekutiv ofron ndihmë edhe në menaxhimin e projekteve të tjera, si dhe kryen punë të tjera në pajtim me kualifikimet e veta.

Lidhjet dhe raportimet

Menaxheri i Projekteve i raporton drejtorit ekzekutiv.

Orët e punës

Menaxheri i projekteve ka orar të plotë të punës prej 8 orëve në organizatë duke u nënshtruar edhe orëve shtesë varësisht prej nevojës dhe kërkesave specifike nga menaxhmenti superior.

Kodi i mirësjelljes

Zbatimi i Kodit të Mirësjelljes është obligim i të gjithë të punësuarve të KEC. Rrjedhimisht, menaxheri i projektit pranon obligimet dhe përgjegjësitë që dalin nga ky dokument.

Kompensimi

Kompensimi i menaxherit të projekteve bëhet konform kontratës së punës dhe mund të ndryshohet apo të modifikohet varësisht prej rezultateve të vlerësimit të performancës dhe vendimeve të drejtorit ekzekutiv.

Versioni	Përshkrim i ndryshimit	Data
1.0	Publikimi fillestar	27.12.2016
1.1	Publikimi i dytë	07.07.2021